



Funded by the
European Union



Dokument hulumtues për identifikimin e praktikave dhe programeve më të mira të riintegritit socio-ekonomik në Kosovë dhe më gjerë për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore

Prishtinë, shkurt 2022



Funded by the
European Union



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	3
SHKURTESAT	4
HYRJE	5
PËRKUFIZIMI I RIINTEGRIMIT	7
KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK NË KOSOVË.....	8
METODOLOGJIA.....	9
PËRKUFIZIMI I DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE	10
Korniza Legjislative dhe e Politikave	11
Mekanizmat Institucional	15
Partnerët Mbështetës Joqeveritar	18
Tregu i Punës	20
Arsimi.....	21
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike	21
Të Drejtat Pronësore	22
Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.....	23
PRAKTIKAT DHE PROGRAMET MË TË MIRA TË RIINTEGRIMIT SOCIO-EKONOMIK	23
Shqipëria: Konteksti i vendit.....	23
Maqedonia e Veriut: Konteksti i vendit.....	28
Polonia: Konteksti i vendit	33
Suedia: Konteksti i vendit	35
Mbretëria e Bashkuar: Konteksti i vendit	38
KONSTATIMET	41
REKOMANDIMET	42



Funded by the
European Union



LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Shkalla e aktivitetit ekonomik të grup-moshës 15-64 vjeç në periudhën 2018-2020	8
Tabela 2: Shkalla e papunësisë së grup-moshës 15-64 vjeç në periudhën 2018-2020	8
Tabela 3: Mbështetja financiare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) për strehimoret në Kosovë për periudhën 2016-2020	17

Autore: Sytrime Dervisholli

Mbikëqyrja: Kosova – Women 4 Women & UN Women - Kosovë

Mohim i përgjegjësisë: Ky raport është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Kosova - Women 4 Women, dhe nuk pasqyron medoemos pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Funded by the
European Union



SHKURTESAT

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
QPS	Qendra për Punë Sociale
CEDAW	Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave
DhF	Dhuna në Familje
BE	Bashkimi Evropian
DhBGj	Dhuna me bazë gjinore
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
KKDhF	Koordinatori Kombëtar Kundër Dhunës në Familje
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
DhNG	Dhuna ndaj Grave
BP	Ballkani Perëndimor
W4W	Kosova - Women 4 Women



HYRJE

Dhuna ndaj grave është njëra nga shkeljet më të përhapura të të drejtave të njeriut pasi ajo merr forma të shumta (dhuna fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike), ushtrohet ndaj vajzave dhe grave të të gjitha moshave, nuk kufizohet në asnjë grup socio-ekonomik ose arsimor dhe ndodh në të gjitha vendet. Pavarësisht përhapjes së saj, dhuna ndaj grave (DhNG) mbetet në hije, ku akoma nevojiten përpjekje të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin e problemit në mënyrë që ai të luftohet në mënyrë më efektive. Megjithëse DhNG është shkelja më e zakonshme e të drejtave të njeriut, të grave, në vendet anëtare të Këshillit të Evropës, progresi në reformën ligjore dhe të politikave ka qenë i ngadaltë. Strategjia e Organizatës për Barazinë Gjinore për 2018-2023 identifikon disa veprime sipas objektivit strategjik 2 (Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje), përfshirë mbështetjen e shteteve anëtare për të zbatuar instrumentet përkatëse ndërkombëtare që ndalojnë dhunën ndaj grave, duke krijuar njohuri për këtë temë dhe ofruar ekspertizë teknike dhe ligjore¹. Kosova - Women 4 Women ka kërkuar përgatitjen e këtij dokumenti hulumtues për shkak të mungesës së përgjithshme të informacionit dhe materialit burimor për praktikën dhe programet më të mira të riintegritimit në Kosovë dhe më gjerë. Prandaj, qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti hulumtues është të eksplorojë se cilat janë praktikën më të mira të planeve dhe programeve të riintegritimit socio-ekonomik në Kosovë dhe më gjerë për gratë që kanë qenë, janë ose mund të jenë viktimë të dhunës.

Detyra është parashikuar si një aktivitet në kuadër të projektit “Mbështetja e aktiviteteve të krijimit të të ardhurave të të mbijetuarve, për riintegrim në shoqëri dhe për t'i shpëtuar ciklit të dhunës”. Projekti financohet nga BE-ja dhe zbatohet nga Kosova - Women 4 Women dhe UN Women. Qëllimi i projektit është fuqizimi ekonomik i grave, ngritja e kapaciteteve të grave për t'u punësuar ose vetëpunësuar në mënyrë që ato të bëhen të pavarura ekonomikisht.

¹ Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (2018), Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore 2018-2023.






Funded by the
European Union



PËRKUFIZIMI I RIINTEGRIMIT

Riintegrimi është një proces. Kur një grua apo vajzë që i ka mbijetuar një eksperience dhune dhe ka vendosur të qëndrojë në një komunitet ose të kthehet në familjen e saj dhe komunitetin e saj të mëparshëm, ky proces njihet si riintegrim. Përkufizimi i fjalës riintegrim është si vijon: “riintegrimi është procesi i përfshirjes dhe rindërtimit të marrëdhënieve brenda komunitetit në vendin e origjinës në katër nivele: nivelin fizik, socio-ekonomik, socio-politik dhe kulturor”. Riintegrimi përkufizohet gjithashtu si *“proces i rimëkëmbjes dhe përfshirjes sociale dhe ekonomike pas përjetimit të dhunës. Ai përfshin vendosjen në mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, qasje në standard të arsyeshëm jetese, mirëqenie fizike dhe mendore dhe mundësi për zhvillim personal, social dhe ekonomik, si dhe qasje në mbështetje sociale dhe emocionale. Një aspekt qendror i riintegrimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi drejt pavarësisë dhe vetë-mbështetjes së tyre si dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre”*.²



² Surtees, R. (2006) Programet e Ri/integrimit në Evropën Juglindore



KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK NË KOSOVË

Procesi i riintegritit socio-ekonomik të grave varet në masë të madhe nga kushtet e përgjithshme sociale, ekonomike dhe politike në vend. Pas një periudhe të gjatë të rritjes ekonomike, ekonomia kosovare së fundmi ka përjetuar pasojat e krizës ekonomike globale të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Gjatë viteve 2017-2019, Kosova kishte tejkaluar vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për sa i përket PBB-së reale, duke shënuar një normë mesatare të rritjes prej 4.3%. Shpërthimi i pandemisë Covid-19 në vitin 2020 çoi në një tkurrje të PBB-së reale të Kosovës me 6.4% në vitin 2020. Vendi tani po rimëkëmbet nga ky recesion i shkaktuar nga pandemia; Rritja reale e PBB-së parashikohet të arrijë në 7.2% në vitin 2021.

Tabela 1: Shkalla e aktivitetit ekonomik të grupmoshës 15-64 vjeç në periudhën 2018-2020 është si vijon³:

	2018	2019	2020
Femrat	18.4%	21.1%	20.8%
Meshkujt	63.3%	59.7%	56.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 2: Shkalla e papunësisë së grupmoshës 15-64 vjeç në periudhën 2018-2020 është si vijon:

	2018	2019	2020
Femrat	33.4%	34.4%	32.3%
Meshkujt	28.5%	22.6%	23.5%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

³ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën* për vitin 2021



Grupmosha 25-64 me diplomë universitare, 37% janë femra, që është një përqindje relativisht e vogël.

Një faktor tjetër që ndikon në ndërhyrjet për riintegrim ndërlidhet me punësimin joformal si një fenomen shumë i përhapur në Kosovë. PBB-ja për kokë banori e Kosovës mbetet më e ulëta në rajon. Ajo arrinte në rreth 26% të mesatares së BE-së në vitin 2020.

COVID-19 pati një ndikim negativ në punësim, pagat dhe varfërinë. Pabarazitë mbesin të përhapura për shkak të një sektori të gjerë informal dhe shkallës së lartë të pasivitetit, veçanërisht në mesin e grave.

Pandemia e COVID-19 ka ndikuar në punësimin dhe jetesën e njerëzve në Kosovë në shumë mënyra dhe në përmasa të ndryshme. Një studim i kryer nga UNDP, UN Women dhe UNFPA [SEIA I, 2020] ka zbuluar një ngarkesë të shtuar të detyrave të shtëpisë tek gratë gjatë pandemisë, dhe një rritje të dhunës ndaj grave dhe vajzave. UNDP ka raportuar se gjatë pandemisë, përqindja e dhunës në familje, e cila kryesisht ka në shënjestër gratë, është rritur me 35%, dhe është shqetësuese për të anketuarat se ato nuk dinë se ku të kërkojnë ndihmë në rast se ato ose dikush përjeton dhunë në familje. Në studimin e dytë të SEIA II (2021), rreth 59% e të anketuarave mendonin se dhuna në familje ishte rritur që nga fillimi i pandemisë. Megjithatë, rezultatet krahasuese të të dhënave sugjerojnë se ndryshimet në lidhje me punësimin dhe orarin e punës u bënë më pak të ashpra në mars të vitit 2021. Përpara pandemisë, 59% e burrave dhe 29% e grave ishin ose të punësuar ose të vetëpunësuar. Ndërkohë që 22% e grave nuk shkuan në punë për të qenë në gjendje të kujdeseshin për detyrat e shtëpisë dhe familjen, asnjë nga burrat nuk kishte raportuar se kishte bërë të njëjtën gjë.⁴

Në përgjithësi, gratë në Kosovë luajnë një rol të rëndësishëm në dy sektorët kryesorë të ekonomisë: shërbimet dhe bujqësia.

METODOLOGJIA

Ky dokument hulumtues aplikon disa qasje metodologjike, duke përfshirë hulumtimin në zyrë, metodologjinë sasiore dhe cilësore, e cila përbëhet nga rishikimi i të dhënave administrative në dispozicion dhe studimeve të kryera në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Poloni, Suedi dhe

⁴ <https://kosovoteam.un.org/index.php/en/130632-rapid-socio-economic-impact-assessment-covid-19-kosovo-3>



Mbretërinë e Bashkuar; intervistat online me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës dhe Total Family Coaching & Parenting në Mbretërinë e Bashkuar dhe; legjislacioni dhe dokumentet e politikave u konsultuan për të kuptuar sistemin në fuqi për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje dhe gjithashtu edhe dokumentet strategjike qeveritare. Konkretisht, dokumenti hulumtues paraqet praktikën më të mira të planeve dhe programeve të riintegritit socio-ekonomik në Kosovë dhe më gjerë për gratë që kanë qenë, janë ose mund të jenë viktimë të dhunës.

Aktualisht nuk ka një hulumtim bazë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për riintegrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave në Kosovë, që janë viktimë të dhunës me bazë gjinore. Prandaj, ky dokument kërkimor synon të trajtojë një çështje të tillë.

PËRKUFIZIMI I DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) mbetet një nga shkeljet më të shpeshta të të drejtave të njeriut në mbarë botën si dhe në Kosovë. Reagimi i duhur nga të gjitha institucionet përgjegjëse është i një rëndësie të veçantë për të luftuar këtë fenomen. Sipas Konventës së Stambollit, DhBGj përkufizohet si: 1) Dhuna që është e drejtuar ndaj një gruaje vetëm për faktin se ajo është grua dhe, 2) Dhuna që prek gratë në mënyrë joproporcionale.

Nuk ekziston një përkufizim universal i dhunës në familje⁵. Në Kosovë, ajo përkufizohet si veprim ose mosveprim i qëllimshëm që rezulton në abuzim, kur kryhet nga personi i cili është ose ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën, si p.sh.

- **Abuzimi fizik:** përdorimi i çdo lloji force fizike; çdo veprim që mund të shkaktojë ose kërcënon të shkaktojë dhimbje fizike; sulm fizik pavarësisht nga pasojat; hyrja me forcë dhe largimi i viktimës nga vendbanimi i përbashkët ose vendbanimi i viktimës; shkaktimi i frikës tek viktimat për mirëqenien e tyre fizike; rrëmbimi.

- **Abuzimi psikologjik:** përdorimi i presionit psikologjik; çdo veprim që mund të shkaktojë ose kërcënon të shkaktojë vuajtje psikologjike; provokimi i ndjenjës së frikës, rreziku personal ose kërcënimi i dinjitetit; fyerja, ofendimi, thirrja me emra fyes dhe forma të tjera të frikësimit të

⁵ OSBE, <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/88708.pdf>



dhunshëm; sjellje të përsëritura me qëllim të degradimit të viktimës; kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së viktimës; shkaktimi i frikës tek viktimat për mirëqenien e tyre emocionale.

- **Abuzimi seksual:** aktet seksuale pa miratim dhe keqtrajtimi seksual.

- **Abuzimi ekonomik:** dëmtimi ose shkatërrimi i pronës ose kërcënimi për ta bërë këtë; shkaktimi i frikës tek viktimat për mirëqenien e tyre ekonomike.

Dhuna në familje është mbi të gjitha një shqetësim i të drejtave të njeriut. Ajo ka rrënjë të thella në marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit. Autoritetet kanë detyrimin të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë të mbijetuarit dhe të ndjekin penalisht autorët.

Një anketë e publikuar në vitin 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2018, zbuloi se 57% e grave të anketuara në Republikën e Kosovës kishin pësuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale që nga mosha 15 vjeçare. vite (më konkretisht, 53% e grave kishin pësuar dhunë psikologjike, 9% dhunë fizike dhe 4% dhunë seksuale nga partneri intim)⁶. Shumë gra në Kosovë (48%) ende e konsiderojnë dhunën e tillë, veçanërisht dhunën në familje, një çështje private, kështu që dhuna me bazë gjinore shpesh kalon pa u vënë re dhe nuk raportohet kurrë. Studimi i OSBE-së zbuloi se gratë me nivele më të ulëta arsimore ishin të varura financiarisht ose ato që jetonin në zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin përjetuar dhunë në familje.

Korniza Legjislative dhe e Politikave

Qeveria e Kosovës i ka vënë vetes si prioritet luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Kjo pasqyrohet edhe në të gjitha hapat e ndërmarrë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politikave kombëtare, të cilat synojnë të harmonizohen gjithnjë e më shumë me standardet ndërkombëtare; si dhe hapa të tjerë të planifikuar për të parandaluar dhe adresuar dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore.

Kushtetuta e Kosovës parasheh që konventat ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, janë drejtpërdrejt të zbatueshme

⁶ “Anketa mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë”, OSBE 2019. Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>. Ajo duhet të plotësohet me raportet e fundit nga Rrjeti i Grave në lidhje me hulumtimin për trajtimin e dhunës në familje. Shih: <https://womensnetwork.org/en/publications/nga-ligjet-ne-vepra/>



Funded by the
European Union



në vend. Asnjë qytetar i Kosovës “nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.” Duke marrë parasysh përfaqësimin në sferën publike, kushtetuta e përcakton se përbërja e Kuvendit të Kosovës, Shërbimit Civil, Gjyqësorit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Prokurorit të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese, duhet të pasqyroj diversitetin e popullit të Kosovës dhe të marrë parasysh parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhunën në familje e përcakton si veprë të veçantë penale ndërsa dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale në marrëdhënie familjare e njeh si dhunë në familje. Kodi Penal i Kosovës është ndryshuar në vitin 2019, duke përfshirë veprat penale në përputhje me Konventën e Stambollit, si dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe gjymtimi i organit gjenital femëror⁷.

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parasheh një sërë masash ligjore që synojnë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Ligji përcakton koncepte të tilla si dhuna në familje dhe marrëdhëniet familjare, dhe shpjegon se cilat masa dhe urdhra mbrojtës ekzistojnë si dhe procedurat që duhen ndjekur për t'i përfituar ata.

Ligji për Barazinë Gjinore përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të barabarta të burrave dhe grave, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Në Kosovë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë dhe Programit për Barazi Gjinore 2020-2024 janë dy dokumentet e politikave që trajtojnë në mënyrë eksplicite çështjen e dhunës ndaj grave.

⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019. Shih: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>



Funded by the
European Union



Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026⁸, Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj katërvjeçar ka prioritet luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Në kuadër të fushëveprimit të saj, Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si një nga 5 objektivat strategjike. Si rrjedhojë, parashihen politika kombëtare për përmirësimin e kuadrit ligjor për ndërmarrjen e iniciativës strategjike dhe planit të veprimit, duke synuar harmonizimin gjithnjë e më të madh të tyre me ato ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare 2022-2026, është e organizuar në katër shtylla kryesore:

- I. Identifikimi dhe parandalimi i dhunës
- II. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare
- III. Forcimi institucional për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave
- IV. Rehabilitimi dhe riintegrimi i qëndrueshëm i viktimave

Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave/të mbijetuarve/të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave është një tjetër aspekt i rëndësishëm që përbën shtyllën e katërt të kësaj strategjie kombëtare.

Kështu, veprimet e parashikuara në kuadër të këtij objektivi strategjik fokusohen kryesisht në ngritjen, zgjerimin ose përmirësimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse, në përpunje dhe harmonizimin me Konventën e Stambollit. Sipas kësaj Konvente, shërbimet e specializuara mbështetëse janë të nevojshme dhe shteti duhet të paktën të sigurojë krijimin dhe funksionimin efikas të këtyre llojeve të shërbimeve: a) Strehimoreve (që ofrojnë akomodim të sigurt, të qasshëm dhe të disponueshëm 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, për të gjitha grupet e grave dhe vajzave ose viktimave/të mbijetuarve/të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave), b) Linjës së ndihmës (e cila duhet të jetë e qasshme në mbarë vendin, në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, pa pagesë, për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje), c) Mbështetjes për viktimat e dhunës seksuale (si qendrat e urgjencës për përdhunimin ose qendrat e referimit për viktimat e dhunës seksuale, ku ofrohet ekzaminimi mjekësor dhe mjeko-ligjor, mbështetja për traumën, këshillim, etj.), d) Mbështetjes për fëmijën dëshmitar të dhunës (shërbimet mbështetëse duhet të marrin parasysh të drejtat dhe nevojat e fëmijës dëshmitar të dhunës dhe këto shërbime

⁸ <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41237>



Funded by the
European Union



duhet të sigurojë këshillimin e duhur psikologjik sipas moshës së fëmijës), e) Mbështetjes përmes Ndhmës Juridike (Këshilltarët e dhunës duhet të ndihmojnë dhe/ose mbështesin viktimat gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore; duhet të parashikohet gjithashtu ofrimi i shërbimeve të duhura mbështetëse për viktimat në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të përfaqësohen dhe të merren parasysh), f) Programe për kryerësit e veprave të dhunës (të cilat parashikojnë dy lloje të ndryshme programesh: për autorët e dhunës në familje dhe për abuzuesit seksualë).

Objektivat specifike të parapara në kuadër të objektivit strategjik IV:

Objektivi specifik IV.1	Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara mbështetëse për viktimat/të mbijetuarit/të mbijetuarit nga të gjitha grupet.
------------------------------------	---

Objektivi specifik IV.2	Zbatimi i politikave të integruara që mundësojnë riintegrimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të viktimave/të mbijetuarve/të mbijetuarve të dhunës.
------------------------------------	--

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024⁹ e definojnë barazinë gjinore si një e drejtë themelore dhe një nga faktorët e rëndësishëm për rritjen ekonomike, zhvillimin dhe stabilitetin në shoqëri.

Koordinimi i masave dhe politikave në fushën e dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës, aktualisht është përgjegjësi e *Zyrës së Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje (KKDhF)*¹⁰.

Objektivi i përgjithshëm strategjik i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është të sigurojë që barazia gjinore të vendoset në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, brenda të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë,

⁹ <https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>

¹⁰ Shih vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Termat e Referencës për emërimin e Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje, të miratuar më 11.07.2012 me Vendimin nr. 04/83.



agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Ky objektivi do të arrihet duke punuar në këto tre drejtime:

- Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, rritjen e përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale dhe për të përfituar nga to;
- Promovimi i barazisë gjinore përmes arsimit dhe shëndetit cilësor, gjithëpërfshirjes dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si faktorë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor, dhe eliminimi i pabarazive dhe stereotipeve gjinore; dhe
- Promovimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi, duke garantuar kështu arritjen e barazisë gjinore.

Gratë janë shpesh më **të cenueshme** në aspektin ekonomik se burrat dhe kështu kanë më pak gjasa të jenë **të qëndrueshme** përballë krizës.

Burimi: Organizata Ndërkombëtare e Punës

Mekanizmat Institucional

- 1. Policia e Kosovës.** Policia e Kosovës në shumicën e rasteve është kontakti i parë për viktimën/të mbijetuarin e dhunës në familje.
- 2. Inspektorati Policor.** Një rol të veçantë në ndihmë të viktimave të dhunës në familje ka Inspektorati Policor/Departamenti i Hetimeve.



3. Mbrojtësi i Viktimës/Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave. Mbrojtësi i viktimës zakonisht takohet me viktimat menjëherë pas përgjigjes së policisë ndaj një rasti të raportuar të dhunës në familje.

4. Prokurori i Shtetit. Ndërveprimi ndërmjet prokurorit dhe viktimës së dhunës në familje zakonisht nis gjatë procesit pas raportimit të rastit.

5. Gjykatat. Gjykatat i shqyrtojnë rastet e dhunës në familje sipas prioritetit të tyre. Këto çështje trajtohen nga gjykata në procedurë civile ose penale në varësi të llojit të rastit.

6. Departamenti i Mjekësisë Ligjore/Ministria e Drejtësisë. Viktimat e dhunës në familje takohen me stafin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore me urdhër të organeve hetimore dhe gjyqësore.

7. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka mandatin të hartojë politika, programe, infrastrukturë ligjore si dhe të monitorojë cilësinë e shërbimeve sociale.

8. Komunat/Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si bartës i pushtetit lokal, është i mandatuar të menaxhojë shërbimet sociale në komunë.

9. Qendrat për Punë Sociale. Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucion publik në nivel komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve që kanë nevojë për shërbime sociale dhe familjare, në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrimin e viktimës. Ajo gjithashtu koordinon aktivitetet me palët e tjera të interesit gjatë procesit të mbështetjes dhe fuqizimit të viktimës.

Kosova është mjaft mirë e mbuluar me legjislacion për sa i përket banimit social. Ekziston Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr. 03/L-164, i cili paraqet një kornizë të avancuar për autoritetet vendore vendimmarrëse për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullsinë në territorin e komunave të Kosovës.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, komunat e Kosovës janë përgjegjëse për zbatimin e skemave që kanë të bëjnë me banimin social, ndërsa përkrahja dhe monitorimi ofrohet nga Ministria e Mjedisit,



Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Këto institucione janë të detyruara të ndihmojnë të gjitha familjet që nuk mund të sigurojnë banim vetë, duke ofruar strehim të përkohshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa i përket zgjedhjes së banimit në banesa kolektive (banime sociale) QPS në bashkëpunim dhe koordinim me akterët e Mekanizmit Koordinues Komunal, mekanizëm i cili udhëhiqet nga Zyra për Barazi Gjinore në secilën komunë, vlerëson, shqyrton dhe vendos për prioritetet e secilit rast, bazuar në nevojat për shërbime të mëtejshme¹¹.

Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit kërkon që komunat të bëjnë vlerësimin e nevojave për banim dhe të përgatisin programe sociale për banim çdo tre vjet. Megjithatë, sipas një raporti të Komisionit Evropian në vitin 2019, “komunat nuk kanë mbledhur të dhëna për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe nuk i kanë përfshirë të mbijetuarat e dhunës në familje në mesin e përfituesve potencialë të programeve të tyre të planifikuara për banim social”. Gratë dhe fëmijët viktima të dhunës në familje mbeten jashtëzakonisht të pambrojtur ndaj mungesës së banimit dhe përjashtimit ndaj gjetjes së banimit për ta, veçanërisht në aspektin e zgjidhjeve afatgjata të banimit.

¹²

10. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas/Zyrat Rajonale të Ndihmës Juridike. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas / Zyrat Rajonale të Ndihmës Juridike ofrojnë ndihmë juridike falas për të mbijetuarat që kanë të drejtë për këtë lloj ndihme.

11. Drejtoritë Komunale të Arsimit/Institucionet Arsimore. Drejtoritë Komunale të Arsimit janë përgjegjëse për ofrimin e edukimit për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje sipas ligjit në fuqi.

12. Institucionet shëndetësore: qendrat parësore, dytësore, terciare dhe të shëndetit mendor. Institucionet shëndetësore kanë një rol të rëndësishëm në evidentimin e rasteve të dhunës në familje.

¹¹ Informacion me shkrim nga Adile Shaqiri, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Janar dhe Shkurt 2022

¹² Haxhikadrija, A. për Komisionin Evropian, Strategjitë kombëtare për luftimin e mungesës së strehimit dhe përjashtimin e banimit– Kosovo, 2019



Funded by the
European Union



13. Zyrrat rajonale të Avokatit të Popullit. Zyrrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë këtë organizim: Njësia për barazi gjinore dhe zyrtari për barazi gjinore. Avokati i Popullit ka përgjegjësinë për të trajtuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut nga shteti.

Partnerët Mbështetës Joqeveritar

- **Strehimoret.** Aktualisht në Kosovë ekzistojnë 8 strehimore të licencuara që ofrojnë një vend të sigurt ku të mbijetuarave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre u ofrohet strehim i përkohshëm, siguri, ndihmë dhe shërbime të tjera. Gjithashtu, ekziston një strehimore tjetër që mbulon katër komunat veriore të Kosovës të banuara nga komuniteti serb. Strehimorja është hapur në qershor të vitit 2020 dhe ndodhet në Zubin Potok.

Sipas Policisë së Kosovës, rastet e dhunës në familje po shtohen nga viti në vit, gjë që tregon se dhuna në Kosovë është një dukuri mjaft e theksuar, ku shumica e rasteve të dhunës kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat. Kështu, në vitin 2016 janë raportuar 1225 raste; në vitin 2017, 1269 janë raste të raportuara; në vitin 2018, 1533 raste të raportuara; në vitin 2019, 1914 raste të raportuara dhe në vitin 2020 janë raportuar 2069 raste.



Funded by the
European Union



Tabela 3: Mbështetja financiare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) për Strehimoret¹³ në Kosovë për periudhën 2016-2020:

Viti i ofrimit të mbështetjes	Nr. i strehimoreve	Shuma mbështetëse
2016	8	252,383.25 Euro
2017	9	290,000.00 Euro
2018	9	193,000.00 Euro
2019	10	324,000.00 Euro
2020	10	495,000.00 Euro

Burimi: Agjencia për Barazi Gjnore, 2021

Më 27 maj 2021¹⁴, Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Divizioni i Shërbimeve Familjare dhe Sociale lançoi një sërë Udhëzuesish Cilësie për Strehimoret për të mbijetuarat e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Udhëzuesit e cilësisë për strehimoret e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje janë të rrënjosura në Konventën e Stambollit dhe në standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe vijnë nga përvojat praktike dhe shembujt e praktikave të mira për administrimin e strehimoreve të grave dhe shërbimeve mbështetëse të grave.

Në bazë të udhëzuesve, projekti i Këshillit të Evropës do të mbështesë Ministrinë për të trajnuar punonjësit socialë dhe stafin e strehimoreve.

¹³ Strehimoret përfshijnë ato strehimore të cilat funksionojnë brenda OJQ-ve dhe ofrojnë strehim për viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore si dhe strehimore për fëmijët e abuzuar, të neglizhuar dhe fëmijët viktimat të formave të ndryshme të krimeve.

¹⁴ <https://www.coe.int/en/web/genderequality/-/launching-quality-guidelines-for-shelters-for-victims-of-violence-against-women-and-domestic-violence-in-kosovo->



Udhëzuesit dhe trajnimet janë pjesë e projektit të Këshillit të Evropës “Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë*-faza II”.

Sipas MFPT, për çështjet e riintegritimit fokusi do të jetë në trajnimin profesional, ndërmjetësimin për punësim dhe përfshirjen në subvencione përmes masave aktive të tregut. Ndërsa me komunat, për të siguruar përfshirjen e tyre në programet dhe planet për sigurimin e çështjes së banimit. MFPT publikon thirrje publike që ofrojnë mbështetje vjetore me subvencione, ku për shembull për vitin 2021 thirrja publike ka qenë diku nga 40 deri në 50 mijë euro në vit. Por në përgjithësi, pjesa e riintegritimit është sfiduese për MFPT-në¹⁵.

OJQ-të janë të njoftuara me problemin e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe janë të informuara mirë për trajtimin e tyre. Ato mund të bëjnë kërkesë për urdhër mbrojtjeje dhe/ose një urdhër mbrojtjeje emergjente.

Tregu i Punës

Pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19 kanë prekur më rëndë gratë sesa burrat. Pasi që shumë prej tyre janë të punësuara në ekonominë informale, ato kishin qasje më të kufizuara në masat mbështetëse lehtësuese. Qeveria ka vazhduar mbrojtjen e grave të mbijetuara të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë shpërthimit të COVID-19. Strehimoret për dhunën me bazë gjinore dhe për trafikimin me qenie njerëzore kanë vazhduar të ofrojnë shërbime në çdo kohë.

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP)¹⁶, në vitin 2020, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Popullsia në moshë pune përfshin moshën 15-64 vjeç. Brenda popullsisë në moshë pune, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 38.3%.

Punësimi më i lartë është tek meshkujt 42.8%, ndërsa punësimi tek femrat është 14.1%.

Femrat janë të punësuara kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë, me 52,7%, ndërsa meshkujt janë të punësuar kryesisht në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit me 44,1%.

Sipas rezultateve të AFP-së, në vitin 2020 shkalla e papunësisë ishte 25.9%.

¹⁵ Intervistë online me Mentor Morinën, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Janar 2022

¹⁶ <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labor-force-survey-in-kosovo-2020>



Funded by the
European Union



Papunësia ishte më e lartë tek femrat me 32.3%, krahasuar me meshkujt me 23.5%. Shkalla më e lartë e papunësisë është në grupmoshën 15-24 vjeç me 49.1%.

Sipas rezultateve të AFP-së, në vitin 2020 fuqia punëtore joaktive është mjaft e lartë në 61.7%, me fokus të veçantë tek femrat me 79.2%, krahasuar me meshkujt me 44.0%.

Rritja e **pjesëmarrjes së grave** në tregun e punës mund të **rrisë produktivitetin** e vendeve, duke çuar në **diversifikim më të madh ekonomik, inovacion** dhe **zvogëlim të varfërisë**.

Burimi: Organizata Botërore e Punës

Arsimi

Arritja arsimore është parashikues kyç i punësimit. Në vitin 2020, shkalla e punësimit (mosha 15-64) ishte 59.9% tek personat me arsim të lartë (universitar), por vetëm 11.3% për ata me arsim fillor. Megjithëse gratë priren të arrijnë nivele të larta arsimore (p.sh. mbi 40% e grave aktive kanë kualifikime të larta kundrejt 20% të burrave aktivë), ato mbeten të nënpërfaqësuar në punësim. Papunësia e të rinjve mbetet e lartë (49.1%), veçanërisht te femrat¹⁷.

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike

Për t'iu përgjigjur situatës pandemike të shkaktuar nga COVID-19, Qeveria e Kosovës (QK) ka miratuar Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike¹⁸ në korrik 2021 dhe një nga masat është mbështetja e punësimit të grave, me 5 milionë euro (Masa 1, nënmasa 1.3 dhe Masa 3, nënmasa 3.5).¹⁹

¹⁷ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën* për vitin 2021

¹⁸ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1250EF76-BBC2-4A35-83DE-E45110E4D664.pdf>

¹⁹ Gratë janë të nën-përfaqësuar në tregun e punës. Për sa kohë që ato përbëjnë gjysmën e popullsisë dhe mbeten jashtë tregut të punës, ne nuk mund të pretendojmë rritje gjithëpërfshirëse pa përfshirjen e grave në tregun e punës. Kështu, për çdo grua që nuk ka qenë e punësuar në 3 muajt e fundit dhe që është e punësuar, do të subvencionojmë 50%



Funded by the
European Union



Të Drejtat Pronësore

Pranohet fakti se qasja ndaj tokës apo çdo prone tjetër të paluajtshme dhe pronësia mbi to është një nga faktorët e fuqizimit ekonomik të grave. Të drejtat pronësore u japin grave siguri, bazë nga e cila mund të prodhojnë, investojnë dhe krijojnë biznesin e tyre dhe të përmirësojnë mirëqenien e tyre. Ndikimi i të drejtave pronësore të grave (ose privimi i tyre) shkon përtej ofrimit të mundësive ekonomike dhe është element thelbësor për aspekte të tjera të fuqizimit dhe mirëqenies së grave.

Anketa Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë²⁰ tregon se informaliteti mbetet një sfidë e rëndësishme në Kosovë; dhe se ekziston një pabarazi e konsiderueshme ndërmjet burrave dhe grave për sa i takon të drejtave të tyre pronësore. Në të njëjtën kohë, Anketa tregon gjithashtu se janë duke vazhduar disa trendë pozitive. Këto përfshijnë rritjen e numrit të të anketuarave që raportojnë se i janë nënshtruar procedurave formale të trashëgimisë; numri i grave që kanë regjistruar pronën në emrin e tyre; dhe numri i grave që kanë nisur procedurën e trashëgimisë.

Në prill të vitit 2021²¹, qeveria zgjati masën pohuese për rritjen e regjistrimit të pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve për gjashtë vjet. Kjo masë, e prezantuar për herë të parë në vitin 2016, ka sjellë një rritje të dukshme të regjistrimit të grave si pronare pronash, nga vetëm 104 në 2016 në 7,417 në 2020.

Korniza ligjore që adreson të drejtat pronësore dhe trashëgimore në Kosovë ofron mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe burrave²². Disa ligje dhe masa administrative rregullojnë në mënyrë të ndërthurur të drejtat pronësore, konkretisht: Ligji për Familjen, Ligji për Trashëgiminë, Udhëzimi Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve dhe Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore.

të pagës për 3 muajt e parë, deri në 150 euro në muaj. Pas periudhës tremujore, kontributi pensional do të subvencionohet sipas masës 1.2.

²⁰ <https://www.land-links.org/wp-content/uploads/2019/06/3.-National-endline-survey-on-proerty-rights.pdf>

²¹ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën* për vitin 2021

²² http://www.k-w4w.org/site/assets/files/1787/learning_brief_alb.pdf



Funded by the
European Union



Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore²³ (FKGK) është një institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që u jep garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e dhëna për NMVM-ve.

Gjatë vitit 2020, pesha e kredive të garantuara për gratë në biznes ishte 15%. Kjo përqindje ka vazhduar të rritet krahasuar me vitet e mëparshme.

FKGK lansoi dritaret e saj në kuadër të Paketës së Rimëkëmbjes Ekonomike, duke ofruar mbështetje për kreditimin në sektorë të caktuar, si prodhimi, shërbimet, bujqësia, tregtia, me fokus të veçantë tek gratë në biznes, bizneset fillestare dhe investimet në efikasitetin e energjisë.

Ekspertët vlerësojnë se do të nevojiten **257 vite për të mbyllur hendekun gjinor** në pjesëmarrjen ekonomike.

Burimi: Organizata Botërore e Tregtisë dhe Grupi i Bankës Botërore

PRAKTIKAT DHE PROGRAMET MË TË MIRA TË RIINTEGRIMIT SOCIO-EKONOMIK

Shqipëria: Konteksti i vendit

Programet e mëposhtme të qeverisë shqiptare janë masa pozitive për të mbushur hendekun midis individëve të përjashtuar nga shoqëria dhe grupit të marginalizuar, ku përfshihen gratë dhe vajzat që kanë vuajtur nga një përvojë dhune:

Mbështetja për gratë që janë të papuna²⁴

²³ https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2021/08/FKGK_Annual-Report_2020.pdf

²⁴ VKM nr.27, datë 11.1.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të grave nga grupe të veçanta”, i ndryshuar.



Funded by the
European Union



Në bazë të këtij programi, punëdhënësit që ofrojnë punësim për punëkërkesit e marginalizuar për të paktën një vit, marrin 100 për qind të pagës minimale për katër muaj dhe 70 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Në rastin e kontratave dyvjeçare, punëdhënësit marrin pagë minimale prej gjashtë muajsh dhe 85 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Po kështu, në rastin e kontratave trevjeçare, punëdhënësit marrin pagë minimale prej gjashtë muajsh dhe 100 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Grupet e synuara që përbëjnë “gratë e marginalizuara” janë gratë e trafikuar, mbi 35 vjeç, gratë rome, gratë me nevojë të veçanta dhe gratë e divorcuara.

Mbështetja për punëkërkesit e papunë në vështirësi²⁵

Sipas këtij programi, punëdhënësit që ofrojnë punësim për punëkërkesit për të paktën një vit përfitojnë deri në 100 për qind të pagës minimale për katër muaj dhe rimbursohen 100 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Përfitues janë personat e papunë afatgjatë, personat përfitues të ndihmës sociale, personat që përfitojnë pagesë papunësie, personat e moshës 15-25 vjeç, që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, personat mbi 45 vjeç që nuk kanë arsimim të mtejshëm përveç atij të mesëm ose të ngjashëm, personat me aftësi të kufizuara, popullsia rome dhe migrantët e kthyer.

Trajnimi në punë për punëkërkesit e papunë²⁶

Sipas këtij programi, punëdhënësve që ofrojnë trajnime në vendin e punës për punëkërkesit e papunë u sigurohet mbështetje financiare në formën e kostove të trajnimit (deri në 70 për qind të kostos). Gjithashtu, punëkërkesit që marrin pjesë në trajnim përfitojnë 50 për qind të pagës minimale gjatë kohëzgjatjes së trajnimit i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se 6 muaj. Gjatë periudhës së trajnimit, të papunësuarës i ndërpritën ndihma financiare dhe përfitimet e papunësisë, por ajo ka të drejtë t'i rikuperojë ato pas përfundimit të trajnimit, nëse nuk punësohet. Punëdhënësi, në fund të periudhës së trajnimit, duhet të punësojë jo më pak se 50 për qind të praktikantëve, për një periudhë 6 mujore.

²⁵ VKM nr.48, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi”, i ndryshuar.

²⁶ VKM nr.47, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet trajnimit në punë”, i ndryshuar..



Programet sociale të strehimit në Shqipëri

Sipas nenit 2/3 të ligjit nr. 9232/2004 “Për Programet Sociale për Strehimin e Banoreve të Zonave Urbane”, i ndryshuar, këto programe zbatohen për strehimin e familjeve dhe individëve që nuk janë të aftë në aspektin ekonomik dhe social të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave. Ligji parashikon tre programe të strehimit social: banesa sociale me qira, banesa me qira të ulët dhe programin e pajisjes së tokës me infrastrukturë. Qeveria ka vendosur gjithashtu dispozitën për subvencion për qiranë sociale, kredi të subvencionuara, grante të vogla dhe grante të menjëhershme për grupe të veçanta²⁷.

Përfituesit e programeve sociale të strehimit duhet të plotësojnë një nga kushtet e strehimit: të kenë mbushur moshën 18 vjeç; nuk kanë apartament në pronësi; kanë në pronësi hapësirë banimi nën normat e përcaktuara të banimit; ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësive natyrore (neni 4). Përzgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e strehimit (familje (familje me një prind, familje me më shumë se katër fëmijë, të moshuar, çifte të reja), kushtet sociale (persona me aftësi të kufizuara, persona me status jetimi, emigrant i kthyer, punëtor migrant, familje të të rënëve punonjës policie, viktima të dhunës në familje).

Sistemi i dixhitalizuar online për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje “Regjistrimi i dhunës në Shqipëri” (REVALB) u krijua në vitin 2014 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e asaj kohe, në bashkëpunim të ngushtë me UNDP-në dhe mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë²⁸.

Zhvillimet e tjera²⁹

Që nga shtatori i vitit 2017, përveç përgjegjësive në fushën e kujdesit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e ngarkuar me zhvillimin e politikave që adresojnë dhunën me bazë gjinore, dhunën ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të

²⁷ Shih UNDP, Strehimi Social në Shqipëri: Analiza e situatës, tetor 2014, përgatitur nga Marsela Dauti.

²⁸ Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara Jepni Fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri (EVAW)

²⁹ Raporti mbi implementimin e rekomandimeve të dhëna Shqipërisë nga Komiteti i Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Qershor 2021



drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimi në bazë të orientimit seksual, paaftësisë, përkatësisë etnike etj.

Gjithashtu në nivel lokal, bazuar në ligjin 9669/2016 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, janë krijuar Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), të drejtuara nga bashkitë (autoritetet përgjegjëse për krijimin dhe fuqizimin e këtyre mekanizmave) dhe mbi bazën e filozofisë së një qasjeje të koordinuar shumësektoriale. MKR-të kanë në përbërjen e tyre të gjitha institucionet vendore përgjegjëse për zbatimin e kuadrit ligjor në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (bashkinë dhe shërbimet e saj sociale, policinë, prokurorinë, gjykatën, mjekun ligjor, përmbaruesin, shëndetësinë, arsimin, shërbimin social shtetëror, punësimin, shërbimin e provës, prefektin e qarkut etj.), si dhe organizatat e shoqërisë civile të specializuara në ofrimin e shërbimeve të nevojshme mbështetëse specialistike për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrje për parandalimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime strehimi, këshillim psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi, informacion dhe ndërgjegjësim, aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për profesionistët, etj.).

Në vitin 2018, pas një propozimi të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Qeveria Shqiptare krijoi një Fond Shoqëror. Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL) planet sociale të të cilave tashmë janë miratuar nga këshillat e tyre komunal përkatës, mund të aplikojnë në Fondin Shoqëror për mbështetje shtesë në plotësimin e nevojave të grupeve të ndjeshme për shërbime sociale. Rreth 80% e NJVL-ve kanë hartuar planet e tyre sociale me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe Shërbimit Social Shtetëror. Këto plane përfshijnë masa për mbështetje të viktimave të dhunës dhe trafikimit, dhe grupeve të tjera të pafavorizuara të grave.

Gjithashtu, qeveria miratoi një VKM në zbatim të Ligjit për Sipërmarrjet Shoqërore, sipas të cilit për periudhën 2019-2021 u miratua një fond për mbështetjen e sipërmarrjeve në shumën 249,760,000 lekë (rreth 2,81 milionë euro), nga të cilat 37,000,000 lekë (rreth 308 mijë euro) janë ndarë për hapjen e vendeve të reja të punës; 7,776,000 lekë (rreth 65 mijë euro) u shpenzuan për mbulimin e pagesave të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e sipërmarrjeve shoqërore që i përkasin grupeve të pafavorizuara, dhe pjesa tjetër shkoi për mbështetjen e këtyre sipërmarrjeve, pas paraqitjes nga ana e tyre të planit të biznesit. Për t’u kualifikuar për



Funded by the
European Union



subvencionim, biznesi duhet të punësojë të paktën 3 të rinj nga grupet e pafavorizuara brenda 12 muajve nga marrja e subvencionit. Ndarja e subvencioneve kushtëzohet me punësimin e personave nga grupet e pafavorizuara me kohëzgjatje të kontratës jo më pak se 2 vjet.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon gjithashtu dy shërbime të specializuara mbështetëse, në nivel kombëtar, të cilat ofrojnë strehim dhe trajtim afatgjatë me fokus riintegrimin, për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit me qenie njerëzore.



Funded by the
European Union



Maqedonia e Veriut: Konteksti i vendit

Gjatë vitit 2021, duke vazhduar punën e 2 viteve të fundit, Rrjeti Kombëtar për Dhënien Fund të Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, së bashku me 6 organizata të shoqërisë civile të grave nga rajoni, vazhdon të punojë intensivisht në ngritjen e shërbimeve për riintegrimin e grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje, në nivel lokal. Në kuadër të projektit “Institucionalizimi i shërbimeve cilësore për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës” të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Rrjeti gjatë vitit 2021, përmes një procesi nën-grantimi po ofron mbështetje për 8 organizata lokale të grave. Këto organizata do të punojnë në 8 rajone të ndryshme në Maqedoninë e Veriut.

Riintegrimi dhe rehabilitimi i grave që i kanë mbijetuar dhunës dhe janë larguar nga mjedisi i dhunshëm është një proces kyç për arritjen e fuqizimit dhe pavarësisë së tyre të plotë, si dhe për të mos u rikthyer tek dhunuesi apo rifillimi i një marrëdhënieje të dhunshme për shkak të varësisë ekonomike. Krijimi i shërbimeve lokale të riintegritit parandalon dhunën ndaj grave dhe fëmijëve në të ardhmen, duke u mundësuar atyre të dalin nga roli i viktimës dhe të bëhen aktorë aktivë në të gjitha proceset shoqërore. Shërbimet e riintegritit përfshijnë strehimin e asistuar të sigurt, mbështetjen financiare afatgjatë, fuqizimin ekonomik dhe këshillimin për karrierë, këshillimin dhe trajtimin psikosocial, si dhe avancimin e arsimit dhe përvetësimin e aftësive të reja. Roli kyç i riintegritit konfirmohet në Ligjin e ri për Eliminimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, në nenin 99 të tij, i cili cek krijimin e Programit për riintegrimin e grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje. Aktivitetet që do të realizohen në nivel lokal në 8 qytete të Maqedonisë së Veriut përfshijnë: Vlerësimin e nevojave të grave viktime në nivel lokal, krijimin e programeve lokale të riintegritit për gratë viktime, dhe avokimin tek institucionet kompetente për ndarjen e fondeve dhe krijimin e shërbimeve të riintegritit.

Për sa i përket mbështetjes financiare afatgjatë, paketa e masave do të përfshinte:

- Përrjashtim nga shpenzimet që lidhen me shkollimin e fëmijëve (furnizime shkollore, ndjekja e aktiviteteve jashtëshkollore që kërkojnë pagesa shtesë, etj.)
- Përrjashtim nga bashkë-pagesa për institucionet parashkollore, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me mësimin në kopshtin e fëmijëve.



Funded by the
European Union



- Përrjashtim të plotë nga bashkë-pagesa për shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe blerjen e barnave
- Përrjashtim nga shpenzimet e transportit publik për të dhe fëmijët e saj (marrja e biletave mujore të transportit publik falas)
- Mundësimi i shfrytëzimit të asistencës direkte financiare nga shteti (Ligji për mbrojtjen sociale, fondet komunale lokale etj.)
- Pagesë alimentacioni për fëmijët, nëse nuk ka rregull në pagesën e alimentacionit
- Futja e sistemit të kuponëve për blerje (MPPS në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile/komunitetin e biznesit, të prezantojë sistemin e kuponëve që do të përdoret për blerjen e produkteve ushqimore/higjienike për të mbijetuarit gjatë riintegritimit të tyre. Kriteret për pranimin e kuponëve mund gjithashtu të përcaktohen në bazë të ndihmës financiare njëherëshe (e rregulluar me ligj), llojit të akomodimit (afatshkurtër ose afatgjatë) dhe të ngjashme³⁰.

Disa iniciativa të kohëve të fundit kanë synuar të forcojnë qasjen në drejtësi, për shembull kursi HELP mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje i lançuar në vitin 2018 për avokatët e Maqedonisë së Veriut³¹. Në vitin 2014, Maqedonia e Veriut kishte miratuar një ligj të ri për parandalimin dhe reagimin ndaj DhBGj-së, me një përkufizim të zgjeruar për të përfshirë dhunën ekonomike dhe ndjekjen. Ligji themeloi një organ kombëtar koordinues me trajnime për ofruesit e shërbimeve dhe sistemin arsimor³². Plani Kombëtar i Veprimit (2018-2023) për zbatimin e Konventës ka tre objektiva kryesore: harmonizimin e kuadrit ligjor; krijimin e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara të dhunës në familje; dhe aktivitetet parandaluese.³³

Shtëpia për Strehim të Hapur³⁴ është shërbimi i parë riintegruar në Maqedoninë e Veriut për gratë viktimat të dhunës në familje, të cilat janë larguar nga mjedisi i dhunshëm. Shtëpia për Strehim të

³⁰ <http://glasprotivnasilstvo.org.mk/en/03-02-2021-local-women-s-organizations-advocate-for-the-establishment-of-reintegration-services-for-women-victims-of-domestic-violence/>

³¹ Këshilli i Evropës (2018) Avokatët maqedonas do të trajnohen për të mbrojtur më mirë viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje [Macedonian lawyers to be trained to better protect victims of Violence against Women and Domestic Violence - News \(coe.int\)](#)

³² UN Women (2014) 'Ligji i ri nxit veprim në Maqedoni' [New law spurs action, bringing protection to many | UN Women](#)

³³ Sproule, K, Dimitrovska, N, Risteska, M, Rames, V (2019) Raporti i analizës gjinore të USAID/Maqedonia e Veriut. Përgatitur nga Banyan Global. 2019

³⁴ <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/en/our-services/house-for-open-housing/>



Funded by the
European Union



Hapur është një formë e jetesës së mbështetur për gratë viktime të dhunës në familje dhe është pjesë e modelit për riintegrimin dhe rehabilitimin e grave viktime të dhunës në familje. Shtëpia për Strehim të Hapur u dedikohet grave viktime të dhunës në familje që kanë ikur nga mjedisi i dhunshëm dhe fëmijët e tyre. Shtëpia mund të strehojë gra, viktime të dhunës në familje, të cilat nuk kanë se ku të qëndrojnë, nuk mund të qëndrojnë në shtëpitë e të afërmeve të tyre, nuk kanë mjete financiare për të siguruar strehim të sigurt për veten dhe fëmijët e tyre, nuk janë të punësuar ose kanë pagë shumë të ulët. Viktimat femra të strehuara në shtëpi nuk janë të rrezikuara nga dhuna nga partneri që ka kryer dhunën, pra janë të divorcuara ose të ndara dhe rreziku i dhunës është tejkaluar para akomodimit në shtëpi.

Shtëpia për Strehim të Hapur ofron strehim nga 6 deri në 24 muaj, ku përfituesit dhe fëmijët e tyre kanë qasje në dhoma gjumi të veçanta dhe zona të përbashkëta si kuzhina, dhoma e ngrënies dhe dhoma e ndenjes. Qëndrimi në Shtëpi mbulon të gjitha shpenzimet e përgjithshme, shpenzimet e ushqimit, higjienën personale, nevojat shkollore të fëmijëve, shpenzimet mjekësore, si dhe shpenzimet gjyqësore dhe shërbimet ligjore. Gjatë qëndrimit, përfituesit marrin këshillim dhe mbështetje për ushtrimin e të drejtave sociale, këshillim të vazhdueshëm individual dhe grupor me psikolog/psikoterapist, mentorim dhe këshillim ligjor dhe ndihmesë për punësim.

Mentori i këshillimit të karrierës³⁵ punon me gra viktime të dhunës, të cilat janë të papuna ose me të ardhura të ulëta. Nëpërmjet seancave individuale, mentori ndihmon gratë në identifikimin e mundësive për karrierë, zgjedhjen e një profesioni, prioritizimin e qëllimeve profesionale, menaxhimin e kohës, zhvillimin e karrierës, etj.

Përveç këshillimit individual, mentori organizon dhe zhvillon trajnime në grup për aftësitë e buta, si për shembull për krijimin i një CV-je dhe për dokumentet mbështetëse të punësimit (letrat e motivimit), përmirësimin e aftësive komunikuese për ndjekjen e intervistave për punë dhe komunikimin me punëdhënësit.

Për më tepër, mentorimi përfshin informimin, ofrimin e udhëzimeve dhe kontaktimin e agjencisë së punësimit dhe asistimin në programet e tyre.

³⁵ <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/en/our-services/career-counseling/>



Funded by the
European Union



Qëllimi i këshillimit për karrierë është fuqizimi i grave dhe rritja e konkurrencës së tyre në tregun e punës. Kjo do t'u japë atyre qasje më të lehtë në punësim dhe fuqizim ekonomik, në mënyrë që ato të arrijnë pavarësinë dhe stabilitetin financiar.

Rrjeti Kombëtar për Dhënie Fund Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje³⁶ ka hapur Fondin e parë të Grave Ndërhjës që ofron ndihmë financiare për gratë viktime të dhunës që duan të largohen nga mjedisi i dhunshëm. Përfituese të Fondit të Grave mund të jenë gra dhe vajza viktime të ndonjë forme të dhunës me bazë gjinore, të cilat e kanë denoncuar rastin në institucionet/organizatat përkatëse dhe janë duke kryer procedurat kundër kryerësit.

Përfituese të Fondit të Grave mund të jenë edhe nënat e pamartuara që kanë qenë viktime të një forme të dhunës me bazë gjinore.

Gratë dhe vajzat viktime të dhunës me bazë gjinore mund të kërkojnë mbështetje nëpërmjet përdorimit të Fondit të Grave, nëse ato gjinden në ndonjërin nga situatat e mëposhtme:

- Janë viktime të ndonjë forme të dhunës me bazë gjinore dhe janë të pasigurta financiarisht (për shembull, të papuna, me të ardhura të ulëta, përfituese të ndihmës sociale);
- Janë nëna të pamartuara;
- Janë të rrezikuara nga mungesa e strehimit.

Fondet ndahen për të plotësuar nevojat ekzistenciale ose për të ofruar një shërbim të caktuar, si më poshtë:

- Ndihma materiale dhe ndihma në natyrë për gratë dhe vajzat viktime të dhunës që do të mbulojë shpenzimet e ushqimit, veshmbathjes, ilaçeve etj.
- Ndihma juridike për përfaqësimin e grave viktime të dhunës në familje (ndihma juridike për fillimin e procedurës në gjykatë dhe vazhdimin e saj deri në momentin kur ndihma juridike falas miratohet nga Ministria e Drejtësisë)
- Mbulimi një herë i faturave të shërbimeve

Udhëzuesi i Mentorimit Social i krijuar nga Shoqata për Kërkim, Komunikim dhe Zhvillim PUBLIC, aftëson profesionistët me aftësi për të punuar sistematikisht me personat vulnerabël të

³⁶ <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/en/intervention-womens-fund/>



Funded by the
European Union



përrjashtuar nga tregu i punës, për t'i pajisur ata me aftësi pune (si të gjeni një punë) dhe aftësi për vetëbesim dhe vetë-realizimi (si të ruhet një punë dhe zhvillimi i karrierës). Të gjitha këto aspekte janë të nevojshme për të përballuar stresin nga marginalizimi dhe përjashtimi shoqëror, në mënyrë që të kapërcehen këto pengesa për punësim³⁷.

³⁷ GIZ & NALAS, Shoqata për Kërkim, Komunikim dhe Zhvillim PUBLIC, Tetor 2021, Mentorimi social – një qasje e aktivizimit të tregut të punës për grupet e cënueshme, Maqedoni e Veriut



Polonia: Konteksti i vendit

Në Poloni dhuna ndaj grave vazhdon të nën-raportohet dhe stigmatizohet, që do të thotë se ajo që raportohet është vetëm një pjesë e realitetit. Në Poloni, 50% e popullsisë priren t'i besojnë policisë, që është dukshëm më e ulët se në BE në përgjithësi (pak mbi 70%).³⁸

Vlerësohet se në Poloni, 19% e grave kanë përjetuar dhunë, që është 14% më e ulët se në BE në përgjithësi.³⁹

Një praktikë premtuese në Poloni është sistemi dhe procedura e ndërhyrjes nga shumë agjenci për dhunën në familje e quajtur Procedura e Kartave Blu.

Në nëntor 2009, qeveria polake lançoi platformën për veprim kundër dhunës seksuale, e cila ofronte procedura të reja për policinë dhe objektet mjekësore që merreshin me viktimat e dhunës seksuale, si dhe dispozita për mbrojtjen e të drejtave të viktimave.

Polonia⁴⁰ ofron shembull të një sistemi të ndërhyrjes nga shumë agjenci për të lehtësuar policimin në nivel lokal dhe ofrimin e shërbimeve në rastet e DhF. Në Poloni, secilës komunë i kërkohet me ligj të krijojë një ekip ndërdisiplinor për të luftuar DhF-në dhe për të bashkërenduar ndihmën për viktimat. Procedura e Kartës Blu u prezantua fillimisht për të standardizuar ndërhyrjen e policisë në rastet e DhF dhe më vonë u zgjerua për të përmirësuar bashkëpunimin e të gjitha shërbimeve përkatëse. Kurdo që ekziston dyshimi i arsyeshëm për DhF, policia ose çdo shërbim tjetër kompetent (shërbimet sociale, ofruesit e kujdesit shëndetësor [mjekët, infermierët, ndihmësmjekët], sistemi arsimor dhe komitetet e qeverisjes vendore për parandalimin e abuzimit me alkoolin) mund të nisin procedurën. Faza e parë është plotësimi i Kartës A, një regjistër i informacionit bazë për incidentin (p.sh. format e dhunës, rrethanat, kushtet shëndetësore, veprimet e ndërmarra nga policia, etj.). Inicimi i Kartës A nuk kërkon pëlqimin e viktimës. Karta A i transferohet ekipit ndërdisiplinor brenda një periudhe jo më të gjatë se 10 ditë. Pas fillimit të procedurës, Karta B i jepet viktimës; ajo përmban informacion bazë për DhF-në, detyrimet e policisë, ligjin penal përkatës dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme. Viktimës i kërkohet të takohet me një menaxher të rastit dhe me

³⁸ Komisioni Evropian (2016). Eurobarometri. i disponueshëm në: <https://europa.eu/eurobarometer/screen/home>

³⁹ Instituti Evropian për Barazi Gjinore: Luftimi i Dhunës ndaj Grave / Poloni

⁴⁰ Burimet: Wiesława Kostrzewa-Zorbas, Këshilltare e Shefit të Kancelarisë së Kryeministrit të Polonisë dhe Krizsan, A. dhe Pap, E. (2016). Zbatimi i Qasjeje Gjithëpërfshirëse dhe të Bashkërenduar. Vlerësim i reagimit të Polonisë për të parandaluar dhe luftuar dhunën me bazë gjinore, Këshilli i Evropës).



Funded by the
European Union



ekipin ndërdisiplinor, kohë në të cilën Karta C përdoret për të regjistruar informacione shtesë rreth viktimës (p.sh. situata familjare, profesionale, ekonomike dhe shëndetësore) në mënyrë që të hartohet një plan ndihme i individualizuar me viktimën. Karta C siguron që është bërë vlerësimi i gjendjes familjare, profesionale, ekonomike dhe shëndetësore të viktimës dhe, nëse është e përshatshme, vlerësohet edhe situata e fëmijëve dhe zhvillohet një plan individual për të ndihmuar viktimën. Kryerësi i veprës thirret gjithashtu të takohet me ekipin ndërdisiplinor, dhe karta D përdoret për të regjistruar informacione shtesë dhe për të përcaktuar veprimet e duhura në lidhje me kryerësin. Rregullorja e Këshillit të Ministrave përcakton rregullat për bashkërendimin e shkëmbimit të informacionit dhe ndërhyrjeve sipas Procedurës së Kartës Blu dhe çdo ekip ndërdisiplinor dokumenton procesin e vet të vendimmarrjes. Sistemi i Kartës Blu ishte një risi e rëndësishme sepse krijoi një platformë për koordinimin e shumë agjencive dhe një kornizë për mbrojtjen e gjithanshme të viktimave të DhF. Sistematizimi i informacionit të mbledhur nga policia (Karta A) ka rezultuar të jetë i dobishëm në ndjekjen penale të rasteve të DhF; edhe pse kartat nuk i përmbushin të gjitha kërkesat e procedurës penale, ato përsëri mund të përdoren si provë. Megjithatë, janë identifikuar edhe disa dobësi në procedurën e Kartës Blu, përkatësisht se ato nuk kanë qenë shumë efektive kur nevojiten reagime të shpejta në situata emergjente. Fakti që viktima takohet si me menaxherin e rastit ashtu edhe me ekipin ndërdisiplinor rrit rrezikun e viktimizimit dytësor. Gjithashtu, kryerësit e veprës nuk janë të detyruar të takohen me ekipin ndërdisiplinor sipas procedurës së Kartës Blu.

Megjithatë, është një hap i rëndësishëm që krijimi i kushteve për sigurimin e banesave sociale për viktimat e dhunës në familje është përfshirë në Programin Kombëtar në Kundërvënien ndaj Dhunës në Familje si një lloj veprimi⁴¹.

⁴¹ <https://rm.coe.int/168064ecd8>



Suedia: Konteksti i vendit

Legjislacioni suedez⁴² për dhunën ndaj grave është i integruar në kodin penal. Dispozitat ligjore shtesë synojnë veçanërisht mbrojtjen dhe mbështetjen ndaj viktimave të dhunës. Legjislacioni në Suedi në përgjithësi nuk e dallon dhunën në familje nga dhuna në fusha të tjera shoqërore, ose në bazë të krimeve sipas gjinisë së dhunuesit ose viktimës. Përrjashtim bën krimi me bazë gjinore “shkelje e rëndë e integritetit të gruas”, pasi ekziston edhe në formën neutrale gjinore, “shkelje e rëndë e integritetit”. Vepra penale 'shkelje e rëndë e integritetit të gruas' ka hyrë në fuqi në vitin 1998 dhe mbulon akte të përsëritura kriminale të drejtuara nga burrat kundër grave me të cilat ata kanë ose kanë pasur një marrëdhënie të ngushtë. Dispozita synon të rrisë vlerën penale të veprave, të cilat së bashku përbëjnë një shkelje të rëndë të integritetit të gruas. Ky është shpesh rasti në lidhje me dhunën në familje. Krahas kësaj dispozite specifike, krimet si sulmi, vrasja dhe krimet seksuale, përfshirë përdhunimin, sigurisht që mund gjithashtu të vlejnjë.

Në vitin 2011, qeveria suedeze shpalli tre plane veprimi për barazinë gjinore (2011-2015). "Plani i veprimit për luftimin e dhunës së burrave ndaj grave, dhunën dhe shtypjen në emër të nderit dhe dhunën në marrëdhëniet e të njëjtit seks" u miratua në vitin 2007 dhe u fokusua veçanërisht në gratë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, abuzimin me substanca ose probleme të varësisë, gratë nga pakicat etnike dhe gratë e vjetra dhe ato të reja.

Suedia është një nga vendet e pakta ku linjat kombëtare të ndihmës për gratë përmbushin standardet e Këshillit të Evropës. Shërbimi shtetëror i linjës ndihmëse, Kvinnofridslinjen, gjithashtu ka faqe interneti. Faqja e internetit kryesisht mbështet gratë e mbijetuarat të dhunës dhe familjet e tyre, por gjithashtu ndihmon profesionistët që punojnë në këtë fushë. Përveç dy linjave kombëtare të ndihmës për gratë, shumica e qendrave të krizës dhe strehimoreve të grave në Suedi kanë linja ndihme dhe chat-i ku gratë nga e gjithë Suedia mund të kenë qasje. Në total, më shumë se 100 linja ndihmëse drejtohen nga qendrat e krizës dhe strehimoret e grave.

Një strategji e re kombëtare 10-vjeçare për parandalimin dhe luftimin e dhunës së burrave ndaj grave ka hyrë në fuqi që nga viti 2017. Objektivi kryesor është që dhuna e burrave ndaj grave duhet të marrë fund dhe ndahet në katër objektiva udhëzuese: veprim më i gjerë dhe efektiv parandalues

⁴² Instituti Evropian për Barazi Gjinore: Luftimi i dhunës ndaj grave / Suedi



ndaj dhunës; zbulim i përmirësuar dhe mbrojtje më e fortë e grave dhe fëmijëve që janë viktime të krimit; zbatim më efektiv i ligjit; dhe njohuri dhe metodave të punës të përmirësuara. Fokusi kryesor i strategjisë, duke u nisur nga një këndvështrim ndërsektorial, është te autori dhe jo tek viktime, tek ekspozimi i grave të reja dhe vajzave ndaj krimit dhe tek përmirësimi i bashkëpunimit dhe metodave të punës të bazuara në njohuri.

Për gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë në familje, Suedia ka 161 strehimore me 631 shtretër. Suedia ka dy linja kombëtare të ndihmës dhe gratë viktime të çdo lloj dhune mund të marrin ndihmë edhe nëpërmjet sms-ve dhe në internet (www.kvinnofridslinjen.se). Për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale, ekzistojnë të paktën tetë qendra të grave që ofrojnë mbështetje të specializuar.

Qeveria ka një program zhvillimor i krijuar për të fuqizuar punën e integritit gjinor brenda agjencive qeveritare. Programi ishte realizuar gjatë periudhës 2013–2018 dhe gradualisht është zgjeruar duke përfshirë pothuajse 60 agjenci qeveritare. Që nga themelimi i saj në vitin 2018, Agjencisë Suedeze për Barazi Gjinore i është caktuar detyra të ofrojë mbështetje për këto agjenci në punën e tyre rreth integritit gjinor.

Agjencia Suedeze për Menaxhimin Publik ka vlerësuar programin për integrimin gjinor brenda agjencive qeveritare. Nga vlerësimi rezulton se autoritetet kanë kryer një punë të gjerë. Për shembull, Agjencia Suedeze për Migracion ka filluar të zbatojë parimin që të gjithë të rriturit duhet të kenë kartën e tyre bankare, e jo si më parë, t'i lëshohet kartelë bankare vetëm burrit në familje. Shembuj të tjerë përfshijnë Agjencinë Suedeze të Taksave, e cila ka zhvilluar një trajtim më të barabartë gjinor të qytetarëve në zyrat e shërbimit të agjencisë, dhe Vinnova, Agjencia Suedeze e Inovacionit, e cila ka rritur përqindjen e grave që udhëheqin projekte në fushën e bizneseve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, Agjencia Suedeze për Rritje Ekonomike dhe Rajonale ka rritur fondet për gratë që drejtojnë biznese nga 7 për qind në vitin 2015 në 13 për qind në vitin 2017. Qeveria ka njoftuar se do të vazhdojë programi për integrimin gjinor brenda agjencive qeveritare. ⁴³

Agjencia Suedeze për Rritje Ekonomike dhe Rajonale ka dyfishuar me sukses burimet financiare të destinuar për bizneset e drejtuara nga gratë, dhe Këshilli Suedez i Kërkimeve tani ka arritur barazinë gjinore në shpërndarjen e granteve kërkimore. Në mënyrë të ngjashme, Komiteti Suedez i Granteve për Arte ka krijuar një mjet për të mbështetur një proces të barabartë gjinor për

⁴³ CEDAW, 15 qershor 2020, <https://www.ohchr.org/en/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=27692&LangID=E>



Funded by the
European Union



vlerësimin e aplikimeve për grante dhe bursa. Autoriteti Suedez i Mjedisit të Punës, Inspektorati Suedez i Shkollave dhe Agjencia e Sigurimeve Shoqërore, të gjithë nga to kanë integruar një perspektivë gjinore në punën e tyre në mënyra të prekshme⁴⁴.

⁴⁴ <https://www.oecd.org/governance/policy-framework-on-sound-public-governance/chapter-one-sweden.pdf>



Mbretëria e Bashkuar: Konteksti i vendit

MB⁴⁵ ka bërë hapa të mëdhenj përpara që nga koha kur Qeveria e Koalicionit Konservator-Liberal Demokrat 2010-15 publikoi thirrjen e parë për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave në vitin 2010. MB kishte prezantuar vepra të reja penale për:

- sjelljen kontrolluese ose shtrënguese;
- përndjekjen;
- të ashtuquajturën 'pornografi hakmarrëse'; dhe
- 'fotografimin poshtë fustanit pa miratimin e vajzës apo gruas.

Britania e Madhe ka:

- ngritur dënimet maksimale për përndjekjen dhe ngacmimin;
- i dha fund lirimit automatik të parakohshëm nga burgu të dhunuesve dhe kryerësve të veprave seksuale me dhunë;
- prezantuar urdhra të rinj për përndjekjen, parandalimin e dëmtimit seksual dhe gjymtimin e organeve gjenitale femërore për të mbrojtur më mirë viktimat dhe ato në rrezik;
- Prezantuar një detyrë të detyrueshme për profesionistët e vijës së parë për të raportuar në polici rastet e FGM-së (gjymtimit të organit gjenital të femrës) tek fëmijët; dhe
- forcoi mjetet në dispozicion të profesionistëve të vijës së parë - duke përfshirë vendosjen e një sërë udhëzimesh statutores, trajnime dhe burime online.

Gjithashtu, vitin e kaluar u miratua Akti i Abuzimit në Familje 2021 ('Akti 2021'). Akti 2021 do të transformojë përgjigjen për 5 në 100 të rritur që kanë vuajtur nga abuzimi në familje gjatë vitit deri në mars 2020, duke forcuar mbrojtjen për ata që kanë përjetuar abuzim dhe dëmtim, ndërkohë që garanton që autorët të ndejnë fuqinë e plotë të ligjit. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar po vazhdon të bëjë investime rekord në mënyrë që viktimat dhe të mbijetuarat të mbështeten me më shumë se 300 milionë funte të investuara vitin e kaluar për ta siguruar këtë. Kjo shumë përfshinte 27 milionë funte për të angazhuar më shumë këshilltarë të pavarur për dhunën seksuale dhe dhunën në familje, të cilët ofrojnë këshilla dhe mbështetje për viktimat.

⁴⁵ Qeveria e MB-së, Adresimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave, korrik 2021



Përveç kësaj, për t'u siguruar që viktimat e dinë se çfarë mund të presin nga policia, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, gjykatat dhe organizatat e tjera të drejtësisë penale, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka prezantuar një Kod të rishikuar të Praktikës së Viktimave të Krimi (Kodi i Viktimave) i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2021. MB-ja është angazhuar tashmë për veprime të rëndësishme shtesë; Ministria e Drejtësisë do të nisë një konsultim për Projektligjin e Viktimave për t'i mbajtur viktimat në qendër të vëmendjes së punës së tyre për të adresuar krimin, dhe gjithashtu do të publikojë një Strategji të re për financimin e viktimave, për të përmirësuar mënyrën e menaxhimit të këtij financimi në të gjithë qeverinë. Veprimet kryesore shtesë që Qeveria do të ndër marrë për të ecur edhe më tej mbi bazën e asaj që është arritur deri më tani, dhe për të siguruar që viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës ndaj grave dhe vajzave të marrin mbështetjen që meritojnë, përfshijnë:

- Home Office do të ofrojë fonde prej 1.5 milion £ për të rritur edhe më shumë ofrimin e shërbimeve "nga dhe për" dhe për të rritur edhe më tej fondet për shërbime të vlefshme të specializuara, siç është linja e ndihmës për "pornografi hakmarrëse";
- Për të mbështetur studentët dhe të rinjtë, Departamenti i Arsimit do të punojë me Zyrën për Studentët për të adresuar ngacmimet dhe abuzimet seksuale në arsimin e lartë (përfshirë universitetet) dhe do të shqyrtoj opsionet për të kufizuar përdorimin e Marrëveshjeve të Mos-zbulimit në rastet e ngacmimeve seksuale në arsimin e lartë; dhe
- "NHS England" dhe "NHS Improvement" po zhvillojnë projekte vendore 'pathfinder' për mbështetje të shtuar për shëndetin mendor të informuar mbi traumat, për viktimat e abuzimit seksual dhe të mbijetuarat me nevojat më komplekse.

Në MB⁴⁶ ka 525 strehimore për gra dhe vajza që janë viktimat/të mbijetuara të dhunës në familje. MB ofron të ashtuquajturin Programi i Lirisë, i cili ekzaminon rolet e luajtura nga qëndrimet dhe besimet mbi veprimet e burrave abuzues dhe reagimin e viktimave dhe të mbijetuarave. Ekzistojnë gjithashtu programe psiko-edukative dhe kurse intensive 2-ditore për abuzuesit. Qasja e informuar mbi traumën është një tjetër shërbim platformë që do t'u ofrohet viktimave dhe të mbijetuarave, i cili trajton ndër gjegjësimin për traumën, sigurinë dhe besueshmërinë, ndërtimin e aftësive, etj. MB ofron trajnime për profesionistët e kujdesit shëndetësor për të përmbushur nevojat e viktimave dhe

⁴⁶ Intervistë online me Adelina Toplica-Badivukun, Trajnere Sistematike e Familjes, Specialiste e Prindërimit dhe Shërimit nga Dhimbja, "Total Family Coaching & Parenting", www.totalfamilycoaching.co.uk, Shkurt 2022



të mbijetuarave të dhunës në familje. Është vlerësuar⁴⁷ se gati gjysmë milioni viktimat dhe të mbijetuar të abuzimit në familje kërkojnë ndihmë nga profesionistët mjekësorë çdo vit. Udhëzimet për profesionistët shëndetësorë tregojnë se “dhuna dhe abuzimi në familje janë kaq të përhapura në shoqërinë tonë, sa që NHS dhe stafi i ofruesve të tjerë do të jenë në kontakt me viktimat e rritur dhe fëmijë (dhe autorët) në të gjithë gamën e shërbimeve shëndetësore”.

Qeveria njihet rolin kyç që organizatat mbështetëse të viktimave dhe të mbijetuarave luajnë duke u ofruar viktimave dhe të mbijetuarave mbështetje/mjete për të rindërtuar jetën e tyre. Thirrja e “Home Office” për Dëshmi thekson kërkesën për shtimin e mbështetjes, për të siguruar që të gjitha viktimat të kenë qasje në mbështetje, pavarësisht karakteristikave të tyre të mbrojtura ose asaj se ku ato jetojnë. Kjo është arsyeja pse qeveria vazhdon të bëjë investime rekord në këtë fushë, ku më shumë se 300 milionë £ nga e gjithë qeveria janë shpenzuar për të mbështetur viktimat dhe të mbijetuarat vetëm këtë vit. Këtu përfshihen:

- 32 milionë £ për shërbime mbështetëse lidhur me dhunën seksuale gjatë tre viteve;
- 27 milionë £ për të rekrutuar më shumë këshilltarë të pavarur për dhunën seksuale dhe dhunën në familje, të cilët janë komponent kyç në mbështetje përmes sistemit të drejtësisë penale, duke rezultuar në rekrutimin e afro 700 pozitave të reja, një rritje prej 44% në raport me mbështetjen ekzistuese;
- 20.7 milionë £ për shërbimet e dhunës seksuale me bazë në komunitet dhe shërbimet e abuzimit në familje, duke ndihmuar në reduktimin e kohës që të mbijetuarit duhet të presin për mbështetje. Shërbimet specifike për meshkujt do të pësojnë një rritje të financimit prej 60% pas rritjes së konsiderueshme të kërkesës për mbështetje nga meshkujt dhe djemtë;
- 2 milionë £ për organizatat më të vogla të specializuara që ndihmojnë personat që kanë prejardhje të ndryshme etnike, viktimat LGBT ose ata me aftësi të kufizuara; dhe
- Paketa mbështetëse prej 1.3 milionë funtash për të mbështetur më shumë viktimat dhe të mbijetuar për të pasur qasje në mbështetje nga shtëpia.

Si përgjigje ndaj ndikimit të COVID-19, qeveria ka ofruar një shtesë prej 76 milion £ për të mbështetur viktimat e abuzimit në familje dhe viktimat seksuale, fëmijët vulnerabil dhe familjet e tyre, dhe viktimat e skllavërisë moderne, si dhe 2 milion £ si mbështetje të menjëhershme për shërbimet e linjës ndihmëse të abuzimit në familje dhe për shërbimet online, veçanërisht për nevoja

⁴⁷ <https://researchbriefings.files.parliament.uk/documents/CBP-9233/CBP-9233.pdf>



Funded by the
European Union



të teknologjisë. NHS England dhe NHS Improvement kanë ofruar 2.5 milion £ për të mbështetur sektorin vullnetar me aktivitet dhe kapacitete për t'u përgjigjur.

KONSTATIMET

Legjislacioni dhe mekanizmat institucionalë për barazinë gjinore janë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së. Ndikimi i pandemisë në mirëqenien e grave ka qenë i madh jo vetëm në Kosovë por edhe në nivel global. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës dhe më gjerë kishin paraparë masa specifike për gratë në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes lidhur me pandeminë, të cilat ndihmuan në zbutjen e disa efekteve negative. Pronësia e grave ndaj pronave është rritur edhe më shumë. Megjithatë, gratë vazhdojnë të përballen me diskriminim në tregun e punës dhe kur ato u qasen financave. Për më tepër, mungojnë programet për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës në familje.

Përvojat e shteteve të BB-së dhe BE-së dëshmojnë se zhvillimi i një modeli gjithëpërfshirës për të trajtuar çështje aq komplekse sa dhe DhNG, kërkon ndarje të resurseve, përfshirë resurset njerëzore dhe financiare, dhe shumë vite punë që përfshin testimin, monitorimin, analizën dhe përshtatjen e qasjeve të reja. Një nga temat e përbashkëta që lidh të gjitha praktikatat e mira është se ato mbështeten nga vullneti politik për të bërë ndryshimin. Një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv duhet të bazohet në korniza të forta ligjore dhe politikash që njohin rëndësinë e vendosjes së nevojave të të mbijetuarve/mbijetuarave në ballë.



Funded by the
European Union



REKOMANDIMET

Rekomandimet e mëposhtme të adresuara për politikë-bërësit synojnë të ofrojnë sugjerime konstruktive nga të cilat do të përfitojnë gra dhe burra të ndryshëm, si dhe barazia e mëtejshme gjinore:

- Krijimi i sistemeve për të matur mbështetjen, sigurinë dhe kënaqësinë e të mbijetuarve me sistemet dhe shërbimet;
- Hartimi i programeve të reja në përputhje me nevojat e identifikuara për zhvillimin e aftësive dhe përshtatja e programeve aktuale të formimit profesional;
- Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve, udhëzimeve ose kodeve të përbashkëta të shërbimeve ose praktikave në të gjithë sektorët që reagojnë ndaj dhunës ndaj grave;
- Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve me trajnime të specializuara për të gjitha format e dhunës ndaj grave në shërbimet e specializuara dhe të përgjithshme;
- Ofruesit e shërbimeve duhet të eksplorojnë më tej krijimin e marrëdhënieve me punëdhënësit në sektorin privat, për të hapur mundësi punësimi, praktike dhe trajnime në vendin e punës.



REFERENCAT

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (2018). Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore 2018-2023

Surtees, R. (2006) Programet e Ri/integrimit në Evropën Juglindore

Raporti i Komisionit Evropian – Kosovë* 2021

OSBE, i disponueshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/88708.pdf>

OSBE 2019. “Anketë mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë”, e disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>. Duhet të plotësohet me raportet e fundit nga Rrjeti i Grave në lidhje me studimin për adresimin e dhunës në familje, e disponueshme në: <https://womensnetwork.org/en/publications/nga-ligjet-ne-vepra/>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019, i disponueshëm në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026, e disponueshme në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41237>

Programi për Barazi Gjinore 2020-2024, i disponueshëm në: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>

Vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe Termat e Referencës për emërimin e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje, miratuar më 11.07.2012, me Vendimin nr. 04/83.

Këshilli i Evropës dhe Qeveria e Kosovës, i disponueshëm në: <https://www.coe.int/en/web/genderequality/-/launching-quality-guidelines-for-shelters-for-victims-of-violence-against-women-and-domestic-violence-in-kosovo->

Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, e disponueshme në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labor-force-survey-in-kosovo-2020>



Funded by the
European Union



Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike, 2021, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1250EF76-BBC2-4A35-83DE-E45110E4D664.pdf>

Anketa Kombëtare e Fundit për të Drejtat Pronësore, e disponueshme në: <https://www.land-links.org/wp-content/uploads/2019/06/3.-National-endline-survey-on-proerty-rights.pdf>

Kosova - Women 4 Women, Përmbledhja e Studimit Gratë dhe Prona, e disponueshme në: http://www.k-w4w.org/site/assets/files/1787/learning_brief_alb.pdf

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, Raporti Vjetor 2020, i disponueshëm në: https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2021/08/FKGK_Annual-Report_2020.pdf

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.27, datë 11.1.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të grave nga grupe të veçanta”, i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.48, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi”, i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.47, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet trajnimit në punë”, i ndryshuar.

UNDP, Strehimi Social në Shqipëri: Analizë e situatës, tetor 2014, përgatitur nga Marsela Dauti.

Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara, Jepni Fund Dhunës ndaj grave në Shqipëri (EVAW)

Rrjeti Kombëtar për t'i dhënë fund Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, shkurt 2021, i disponueshëm në: <http://glasprotivnasilstvo.org.mk/en/03-02-2021-local-women-s-organizations-advocate-for-the-establishment-of-reintegration-services-for-women-victims-of-domestic-violence/>



Funded by the
European Union



Maqedoni e Veriut: Shënim Informues për Çështjet Gjinore

Wiesława Kostrzewa-Zorbas, Këshilltare e Shefit të Kancelarisë së Kryeministrit të Polonisë dhe Krizsan, A. dhe Pap, E. (2016), Zbatimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduar. Vlerësim i reagimit të Polonisë për të parandaluar dhe luftuar dhunën me bazë gjinore, Këshilli i Evropës.

Instituti Evropian për Barazi Gjinore: Luftimi i Dhunës ndaj Grave / Poloni

Këshilli i Ministrave, Varshavë 2014. “Programi Kombëtar për Parandalimin e Dhunës në Familje për 2014-2020”

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Shqipërisë, Qershor 2021. “Raport mbi zbatimin e rekomandimeve të adresuara Shqipërisë nga Komiteti i Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)”

GIZ & NALAS, Shoqata për Kërkim, Komunikim dhe Zhvillim PUBLIC, Tetor 2021, Mentorimi social – një qasje për aktivizimin e tregut të punës për grupet e cënueshme, Maqedonia e Veriut

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, të disponueshme në:
<https://sdgs.un.org/goals/goal5>

Grupi i Bankës Botërore dhe Organizata Botërore e Tregtisë, 2020. Gratë dhe Tregtia: Roli i tregtisë në promovimin e barazisë gjinore, i disponueshëm në:
https://www.wto.org/english/res_e/publications_e/women_trade_pub2807_e.htm